



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

|                                  |                                                                                                                                                                  |                  |
|----------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| Për :                            | Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës<br>Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës                                                          |                  |
| Kopje:                           | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë<br>Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/<br>MAPL |                  |
| Përmes: <i>PER: BAJRAN GECAP</i> | Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL-së                                                                       |                  |
| Nga:                             | Besim Myrtezani, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL                                                                         | Datë: 13/02/2017 |
| Lënda:                           | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Podujevës                                                                                                       | 020/288          |
| Lloji i aktit:                   | Vendim                                                                                                                                                           |                  |

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01-462/01-6058/17 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

E miratuar më datë më datë: 02.02.2017

E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.02.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

|                            |                                                                                                                                                 |                      |
|----------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Za :                       | Agim Velju, gradonačelnik opštine Podujevo<br>Mehmet Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Podujevo                                           |                      |
| Kopija:                    | Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u<br>Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini<br>Pravno odeljenje i monitorisanje opština, MALS |                      |
| Preko: ZA: BAJRAM<br>GECAD | Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u                                                             |                      |
| Od:                        | Besim Murtezani, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS                                                               | Datum:<br>13/02/2017 |
| Predmet:                   | Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Podujevo                                                                                             | 020/288              |
| Vrsta akta:                | Odluka                                                                                                                                          |                      |

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

|                                                                                                                                  |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Odluka br. 01-462/6058/17 za davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine Ministarstvu za rad i socijalnu zaštitu. |
| Usvojena dana: 02.02.2017.                                                                                                       |
| Dostavljena MALS-u na razmatranje dana: 07.02.2017.                                                                              |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je isti u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za bilo kakvo dodatno objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



|                                                            |  |  |  |
|------------------------------------------------------------|--|--|--|
| HYRESE-ULAZNA-INCOMING                                     |  |  |  |
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKAN E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA |  |  |  |
| QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA        |  |  |  |
| Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal               |  |  |  |
| Ministertve Lokale Saminprave / Administracije             |  |  |  |
| Ministry of Local Government Administration                |  |  |  |
| Data / Datum / Date                                        |  |  |  |
| 07.02.2017                                                 |  |  |  |
| Niveli organizativ / Nr. i Lendës / Shifra / Vlera         |  |  |  |
| -2- 40-28                                                  |  |  |  |



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI

Në bazë të nenëve 11, 12 paragrafi 2 shkronja d), 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenëve 6 paragrafi 1.3, dhe 10 paragrafi 1.1 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144, nenin 20 paragrafi 3.1.3 të Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenëve 14, 15.2 shkronja d), dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, sipas kërkesës së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nr.02/288 të datës 26.01.2017, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 02 shkurt 2017, miratoi,

## VENDIM

### PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

#### Neni 1

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për ndërtimin e Objektit të Qendrës për Aftësi Profesionale, i jepet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme e Komunës, e evidentuara në Certifikatën Pronësore nr. 08/463/02/5673/17 të datës 01.02.2017, njësi kadastrale Parcelë nr. P-71712062-02869-2 në sipërfaqe prej 1500 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur Qytet. Zona kadastrale Podujevë.

#### Neni 2

Afati i dhënies në shfrytëzim është 99 ( nëntëdhjetenëntë ) vite.

#### Neni 3

Shfrytëzimi i pronës jepet pa kompensim.

#### Neni 4

Kontratat për dhënie në shfrytëzim të pronës, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

#### Neni 5

Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta, e evidenton në RDPP (Regjistrin e të drejtave të pronave të paluajtshme) në elaboratin kadastral, ndërsa Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i përcakton kushtet teknike - urbanistike, për ndërtimin e objektit të cëkur.

#### Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyren e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-462/01-6058/17  
Podujevë,  
02 shkurt 2017







|                                       |          |
|---------------------------------------|----------|
| REPUBLIC OF KOSOVO                    |          |
| Ministry of Labour and Social Welfare |          |
| Received by:                          | 288      |
| Date:                                 | 26.01.17 |

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zastite**  
**Ministry of Labour and Social Welfare**

**ZYRA E PROKURIMIT**

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

|                                              |     |                                                                                                                                                                 |            |
|----------------------------------------------|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>REFERENCE:</b>                            |     | PROC /26/01/2017                                                                                                                                                |            |
| <b>PËR/ZA/TO:</b>                            |     | z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës                                                                                                                   |            |
| <b>CC:</b>                                   |     |                                                                                                                                                                 |            |
| <b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>                 |     | z. Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm/MPMS                                                                                                                  |            |
| <b>NGA/OD/FROM:</b>                          |     | Feti Ibishi, Kryesues i Divizionit të Prokurimit/MPMS                                                                                                           |            |
| <b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>                |     | KËRKESË PËR SIGURIMIN E PARCELËS DHE DOKUMENTACIONIT<br>TEKNIK PËRCJELLËS PËR NDERTIM TË OBJEKTIT TË NJESISE SE<br>QENDRES SE AFTËSIMEVE PROFESIONALE-PODUEJEVE |            |
| <b>Nr. i zyrës:</b>                          | 408 | <b>Lokacioni:</b>                                                                                                                                               | PRISHTINË  |
| <b>Br. kancelarije:</b>                      |     | <b>Kuçi:</b>                                                                                                                                                    |            |
| <b>Room No.:</b>                             |     | <b>Extension:</b>                                                                                                                                               |            |
| <b>PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL</b> |     | <b>Data:</b>                                                                                                                                                    | 26/01/2017 |
| <b>PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE</b> |     | <b>Datum:</b>                                                                                                                                                   |            |
| <b>AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE</b>             |     | <b>Date:</b>                                                                                                                                                    |            |

I nderuar z. Kryetar,

Ju njoftojmë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të projekteve kapitale për vitin 2017, ka planifikuar të ndërtojë në komunën e Podujevës objektin e njësise së Qendrës së Aftësimeve Profesionale.

Për këtë qëllim, ju drejtohem me kërkesën për ndarjen e parcelës në sipërfaqe prej 1500 m2 për ndërtimin e objektit, si dhe sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm si: Kopjen e Planit, Fletëposedimi, Situ. kart, Kushtet Teknike-bazuar në parcelën e siguruar prej Kuvendit Komunal, për ashtu na nevojiten pëlqimet për kycje në komunal: Pëlqimin nga KEDS - u për energji elektrike, Pëlqimin nga kompania

Rajonale për kycje në ujësjellës dhe kanalizim dhe ngrohje qendrore (nëse ka në nivel të komunës).

Me kompletimin e dokumenteve të sipërpërmendura na mundësohet të punojmë projektin Ideor dhe Kryesorë dhe të fillojmë sa më shpejtë me ndërtimet, prandaj ju lutemi për sigurimin sa më të shpejtë të dokumentacionit të nevojshëm.

Me respekt.